ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **(Keshilli Prokurorial i Kosovës)**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:*(**250-26-9665-1-2-1**)*
Sa i përket tenderit për*(**Furnizim dhe funksionalizim i UPS-it qendror për objektin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë)***

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ARITECH SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kilometri i 10 Prishtinë-Lipjan, përball QMI _ ___
(Adresa)

Graçanicë **10500**
(Vendi)(Kodi postar)

+383 38 600 500
(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it)

Fahri Avdiu
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

fahri@aritechks.com
(Adresa elektronike)



23.11.2026
(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate eshte ngarkuar ne e-prokurim me dt. 03.11.2026 *Afati i fundit per dorezim te ofertes eshte shtyer deri me date 24.11.2026 h 14:00.*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ **Jo** ☐

Kjo ankesë paraqitet pas përfundimit të procedurës paraprake për zgjidhjen e mosmarrëveshjes pranë Autoritetit Kontraktues. ARITECH SH.P.K., më 10.11.2026, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër dokumenteve të tenderit, përkatësisht kundër specifikimeve teknike të cilat, sipas vlerësimit tonë, kufizojnë konkurrencën dhe favorizojnë një prodhues të caktuar.
Me vendimin e datës 12.11.2026, Autoriteti Kontraktues e ka Refuzuar kërkesën për rishqyrtim.
Për këto arsye, dhe me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesit tonë ligjor, jemi të detyruar ta paraqesim këtë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë realizimit të kësaj procedure ka shkelur dispozitat e LPP-së si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6
Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Neni 28
Specifikimet teknike

1. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent"

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

ARITECH SH.P.K., ne cilesine e operatorit ekonomik te interesuar per pjesemarrje ne aktivitetin e lartcekur te prokurimit, paraqet kete ankese prane Organit Shqyrtues te Prokurimit, duke kundershtuar vendimin e Autoritetit Kontraktues per refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim.

Fillimisht po theksojme afatet procedurale te kerkesave per sqarime shtese dhe afatit te Kerkesave per Rishqyrtim.
Dosja e tenderit eshte publikuar me 03.11.2026, ndersa afati per sqarime dhe kundershtimin e dokumenteve ka qene 10.11.2026, me afat fillestar per ofertim 16.11.2026.
Kjo perputhje e afateve ka krijuar veshtiresi procedurale, pasi operatoret ekonomik jane detyruar te paraqesin kerkese per rishqyrtim pa pritur pergjigjen e AK-se ndaj sqarimeve, duke rrezikuar humbjen e se drejtes per kundershtim.
Konsiderojme se kjo situate ka cenuar efektivitetin e mjeteve juridike dhe transparencen e procedures.

Konsiderojme se Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kerkesen tone pa ofruar argumentim te mjaftueshem teknik dhe juridik lidhur me ceshtjet e ngritura, vecanerisht sa i perket hartimit te specifikimeve teknike te cilat krijojne avantazh per konfigurime dhe produkte te caktuara.
Ne vleresimin tone, kombinimi i parametrave te kerkuar per sistemin UPS, modulet dhe baterite krijon dyshime serioze per kufizim te konkurrencen se lire dhe favorizim te nje zgjidhjeje teknike te identifikueshme.
Kjo gjendje cenon parimet e trajtimit te barabarte, mosdiskriminimit dhe transparences, te percaktuara ne nenin 7 te Ligjit per Prokurimin Publik, si dhe kerkesat e nenit 28 lidhur me hartimin e specifikimeve teknike.

Specifikimet teknike krijojne avantazh per modelin Delta Modulon DPH-80K-FR

Autoriteti Kontraktues ka percaktuar furnizimin me sistem UPS trefazor, me kapacitet fillestar prej 40 kVA dhe mundesi zgjerimi deri ne 80 kVA, duke kerkuar gjithashtu autonomi prej 15 minutash ne ngarkese 100%.
Nga dokumentacioni teknik i prodhuesit Delta Electronics rezulton se modeli Delta Modulon DPH-80K-FR mbeshtet konfigurimet modulare 20/40/60/80 kVA.
Kjo perputhje paraqet nje tregues konkret qe duhet te shqyrtohet se bashku me parametrat e tjere te dosjes, perfshire arkitekturen e moduleve, numrin e baterive dhe emertimet specifike te komponenteve.
Ne vendimin e kontestuar, Autoriteti Kontraktues eshte kufizuar ne deklarimin se specifikimet teknike jane hartuar sipas nevojave funksionale te institucionit dhe se nuk synojne favorizimin e ndonje prodhuesi.
Megjithate, Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur ndonje analize teknike krahasuese qe te demonstroje se kombinimi i specifikimeve te kerkuara mund te permbushet edhe nga zgjidhje alternative te prodhuesve te tjere.
Theksojme se objekt i kundershtimit nuk eshte vete kerkesa per kapacitet 40 kVA ose zgjerim ne 80 kVA, por kombinimi i kerkesave qe mund ta beje konkurrencen praktikisht te kufizuar ne nje arkitekture te caktuar.
Ne kete drejtim, konsiderojme se Autoriteti Kontraktues duhet te deshmoje arsyet teknike dhe funksionale per parametrat qe kufizojne zgjidhjet alternative.
Kerkojme nga OSHP qe te shqyrtoje perputhshmerine e specifikimeve me nenin 28 te LPP-se dhe, permes ekspertizes teknike, te verifikoje nese ato krijojne avantazh te pajustifikuar per modelin Delta Modulon DPH-80K-FR.

Percaktimi i 16 moduleve me emertim specifik kufizon konfigurimet alternative

Ne paramasen e tenderit kerkohet furnizimi me 16 cope module me emertimin:
"BATTERY PACK ASSY W/O BATT".
Kjo kerkese nuk percakton vetem rezultatin funksional qe duhet te arrihet, por gjithashtu percakton numrin dhe emertimin e komponenteve te sistemit.
Ne pergjigjen e tij, Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se numri i moduleve eshte percaktuar duke marre parasysh konfigurimin e vendit te instalimit, hapesiren fizike, lokacionin dhe integrimin me infrastrukturen ekzistuese.
Megjithate, ne vendimin e kontestuar nuk jane paraqitur dimensionet e hapesires se instalimit, vizatimet teknike, kufizimet konkrete infrastrukturore ose ndonje analize qe demonstron pse nje konfigurim alternativ i moduleve nuk do te mund te realizonte te njejtin funksion.
Konsiderojme se nevoja per pershtatje me ambientin ekzistues mund te justifikoje kerkesa per dimensione maksimale, siguri, kapacitet dhe integrim, por jo domosdoshmerisht percaktimin e nje arkitekture te vetme.
Per kete arsye, kerkojme qe OSHP te shqyrtoje nese numri fiks prej 16 moduleve eshte objektivisht i domosdoshem apo nese i njejti rezultat mund te arrihet edhe me organizime te tjera teknike.

Parametrat e baterive krijojne profil teknik teper specifik
Autoriteti Kontraktues ka kerkuar bateri 12 V / 9 Ah, me jetegjatesi nominale 10+ vite, si dhe parametra te vecante lidhur me peshen, dimensionet, rezistencen e brendshme, rrymen e qarkut te shkurter dhe karakteristikat e shkarkimit.

Ne Kerkesen per Rishqyrtim kemi identifikuar ngjashmeri te konsiderueshme te disa prej ketyre parametrave me modelet CSB HRL1234W dhe HRL1234WF2FR.
Ne vendimin e tij, Autoriteti Kontraktues ka pranuar se disa karakteristika mund te jene te ngjashme me produkte te caktuara, por ka deklaruar se kjo nuk deshmon favorizim.
Ne nuk konsiderojme se ngjashmeria e nje parametri te vetem perben domosdoshmerisht shkelje ligjore.
Megjithate, kur disa parametra teper specifike percaktohen njekohesisht si kushte te detyrueshme, krijohet mundesia qe produkte me performance te barasvlershme te perjashtohen per dallime qe nuk ndikojne ne funksionimin real te sistemit.
Autoriteti Kontraktues nuk ka demonstruar ne menyre konkrete perse secili prej parametrave, perfshire peshen, rezistencen e brendshme dhe rrymen e qarkut te shkurter ne vlerat e percaktuara, eshte i domosdoshem per realizimin e kontrates.
Per me teper, kerkesa per jetegjatesi nominale 10+ vite duhet te vleresohet ne lidhje me kushtet reale te operimit, temperaturen, regjimin e ngarkimit dhe karakteristikat e sistemit.
Kerkojme nga OSHP qe te realizoje nje vleresim te pavarur teknik per te konstatuar nese specifikimet e baterive jane te arsyetuara funksionalisht apo krijojne kufizime te pajustifikuara per produktet ekuivalente.

Mungesa e llogaritjes se dokumentuar te autonomise
Autoriteti Kontraktues ka kerkuar qe sistemi UPS te siguroje autonomi prej 15 minutash ne ngarkese 100%, duke percaktuar njekohesisht numrin prej 160 baterive.
Ne Kerkesen per Rishqyrtim kemi ngritur ceshtjen e verifikimit te autonomise bazuar ne parametrat e shkarkimit te baterive.
Sipas tabeles se paraqitur ne kerkesen tone, vlera orientuese e fuqise se shkarkimit prej 213 W per bateri jep:
160 × 213 W = 34,080 W.
Kjo vlere nuk perben vetvetiu prove perfundimtare se autonomia e kerkuar nuk arrihet, pasi rezultati varet nga konfigurimi elektrik, rendimenti i UPS-it, faktori i fuqise dhe kushtet e shkarkimit.
Megjithate, ajo paraqet arsye konkrete per kerkimin e nje llogaritjeje teknike te dokumentuar.
Ne pergjigjen e tij, Autoriteti Kontraktues eshte mbeshtetur ne pervojen e instalimeve ne objektet e tjera, pa paraqitur llogaritjen e autonomise per konfigurimin konkret te kerkuar ne kete aktivitet prokurimi.
Konsiderojme se pervoja e meparshme e instalimeve nuk mund ta zevendesoje verifikimin teknik te nje sistemi konkret.
Kerkojme nga OSHP qe te urdheroje shqyrtimin e parametrave te autonomise dhe te kerkoje arsyetimin teknik te konfigurimit prej 160 baterive.

Kriteret ISO 9001 dhe ISO 14001 dhe proporcionaliteti i tyre
Autoriteti Kontraktues ka percaktuar si kushte kualifikimi posedimin e certifikatave ISO 9001 dhe ISO 14001 nga operatori ekonomik.
Ne Kerkesen per Rishqyrtim kemi kundershtuar proporcionalitetin e ketyre kerkesave ne raport me objektin dhe vleren e parashikuar te kontrates prej 30,000 EUR.
Ne pergjigjen e tij, Autoriteti Kontraktues eshte mbeshtetur ne nevojen per sigurimin e cilesise, kontrollin e proceseve dhe menaxhimin e aspekteve mjedisore.
Nuk e kontestojme rendesine e sigurimit te cilesise dhe mbrojtjes se mjedisit.
Megjithate, konsiderojme se duhet te vleresohet nese detyrimi per posedimin e te dy certifikatave nga vete operatori ekonomik eshte proporcional me natyren dhe kompleksitetin e kontrates.

Gjithashtu, duhet te verifikohet nese dokumentet e tenderit lejojne pranimin e deshmive te barasvlershme ne pajtim me dispozitat e aplikueshme te LPP-se.
Kerkojme qe OSHP te shqyrtoje proporcionalitetin e ketyre kritereve dhe mundesine e pranimit te deshmive ekuivalente.

Efekti i kombinuar i kerkesave kufizon konkurrencen
Pervec specifikimeve te detajuara teknike, Autoriteti Kontraktues ka percaktuar edhe kritere lidhur me:

- Qarkullimin financiar prej 50,000 EUR.
- Kontratat e ngjashme me vlere 45,000 EUR.
- Certifikatat ISO 9001 dhe ISO 14001.
- Autorizimin e prodhuesit ose dilerit.
- Angazhimin e personelit profesional me pervoje te percaktuar.
- Konfigurimin specifik te UPS-it dhe baterive.

Nuk konsiderojme se secila nga keto kerkesa eshte domosdoshmerisht e kunderligjshme kur shqyrtohet e vecuar.
Megjithate, efekti i tyre i kombinuar duhet te vleresohet ne raport me objektin e kontrates, vleren e parashikuar dhe ndikimin ne pjesemarrjen reale te operatoreve ekonomik.
Ne vendimin e kontestuar, Autoriteti Kontraktues i ka arsyetuar keto kritere ne terma te pergjithshem, pa paraqitur nje vleresim te dokumentuar te ndikimit te tyre te perbashket ne konkurrence.
Per kete arsye, kerkojme nga OSHP qe te shqyrtoje nese kombinimi i kritereve krijon barriera joproporcionale per pjesemarrjen e operatoreve ekonomik.

KUNDERSHTIMI I ARSYETIMIT TE VENDIMIT TE AUTORITETIT KONTRAKTUES
ARITECH SH.P.K. konsideron se vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk i ka trajtuar ne menyre te mjaftueshme ceshtjet teknike qe jane ngritur ne Kerkesen per Rishqyrtim.
Ne pjesen me te madhe te pergjigjeve, Autoriteti Kontraktues deklaron se kerkesat jane hartuar sipas nevojave te institucionit dhe se nuk kane per qellim favorizimin e ndonje prodhuesi.
Megjithate, deklarimi i qellimit nuk eshte i njejte me demonstrimin e ndikimit real te specifikimeve ne konkurrencen e tregut.
Vleresojme se shqyrtimi i pajtueshmerise me nenin 28 te LPP-se duhet te marre parasysh jo vetem arsyet e deklaruara nga Autoriteti Kontraktues, por edhe efektin objektiv te kerkesave teknike mbi mundesine e ofertimit te produkteve te barasvlershme.
Per kete arsye, konsiderojme se vendimi i refuzimit nuk ofron arsyetim te mjaftueshem per te hedhur poshte ceshtjet e ngritura lidhur me kufizimin e konkurrences.
Ne vecanti, mbetet e paverifikuar nese kombinimi i specifikimeve te kerkuara mund te permbushet nga nje numer i arsyeshem prodhuesish dhe nese kufizimet e vendosura jane te domosdoshme per nevojat funksionale te institucionit.

Bazuar ne faktet dhe argumentet e paraqitura, kerkojme nga Organi Shqyrtues i Prokurimit:

1. Te aprovoje ankesen e ARITECH SH.P.K. si te bazuar, ne masen qe konstatohen shkeljet e dispozitave te Ligjit per Prokurimin Publik.
2. Te anuloje vendimin e Autoritetit Kontraktues te dates 12.11.2026, me te cilin eshte refuzuar Kerkesa per Rishqyrtim.
3. Te shqyrtoje perputhshmerine e specifikimeve teknike me nenin 28 te LPP-se, vecanerisht ne raport me mundesine e favorizimit te modelit Delta Modulon DPH-80K-FR.
4. Te caktoje ekspertize teknike te pavarur per verifikimin e kombinimit te kerkesave per UPS-in, modulet dhe baterite.
5. Te verifikoje nese specifikimet e baterive jane percaktuar ne baze te nevojave funksionale apo pasqyrojne karakteristika te vecanta te produkteve te identifikueshme.
6. Te shqyrtoje arsyeshmerine e percaktimit te 16 moduleve dhe 160 baterive, duke kerkuar dokumentacionin teknik perkates dhe llogaritjet e autonomise.
7. Te shqyrtoje proporcionalitetin e kritereve te kualifikimit, perfshire certifikatat ISO 9001 dhe ISO 14001, si dhe pranimin e deshmive te barasvlershme.
8. Te urdheroje korrigjimin e specifikimeve teknike qe rezultojne kufizuese ose diskriminuese dhe percaktimin e tyre mbi bazen e kerkesave funksionale, performances dhe sigurise.
9. Te mundesoje konkurrencen reale ndermjet prodhuesve dhe operatoreve ekonomik, pa cenuar standardet teknike dhe cilesine e pajisjeve qe kerkohen nga institucioni.
10. Te urdheroje masat procedurale te nevojshme per garantimin e efektivitetit te shqyrtimit te ankeses dhe, nese dokumentet e tenderit korrigjohen, te sigurohet afat i mjaftueshem per pergatitjen e ofertave.

ARITECH SH.P.K. thekson se kjo ankese nuk ka per qellim uljen e standardeve teknike, te sigurise apo te cilesise se sistemit UPS.
Qellimi yne eshte qe specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit te jene objektive, proporcionale, te arsyetuara dhe te zbatueshme ne menyre te barabarte per te gjithe operatoret ekonomik.
Vleresojme se dokumentacioni i shqyrtuar krijon baze per verifikim te metejme teknik lidhur me favorizimin e mundshem te nje konfigurimi specifik dhe kufizimin e pajustifikuar te konkurrencen.
Per kete arsye, kerkojme nga OSHP qe ta shqyrtoje ankesen ne teresi, te vleresoje provat dhe argumentet e paraqitura dhe te marre vendim ne perputhje me Ligjin per Prokurimin Publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasoje e specifikimeve teknike dhe kritereve te kundershtuara, ARITECH SH.P.K. rrezikon te kufizohet ne mundesine per te pergatitur dhe dorezuar nje oferte konkurruese. Kufizimi i mundesise per ofertimin e zgjidhjeve teknikisht ekuivalente cenon interesin tone legjitim ekonomik per pjesemarrje ne kete aktivitet prokurimi.

Demi i mundshem ekonomik perfshin shpenzimet per analizimin e dokumentacionit, pergatitjen e ofertes, sigurimin e dokumentacionit teknik, angazhimin e burimeve profesionale dhe humbjen e mundesise reale per konkurrim dhe realizim te kontrates.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të*
d) *Kerkesa per Rishqyrtim e datës 10.11.2026*
e) *Vendimi i AK-se rreth kerkeses per Rishqyrtim date 12.11.2026*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*